

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41./2014, 53/ 16 dhe 83/18), duke vepruar sipas një njoftimi për përqendrim të parashtruar nga Mosburger GmbH, me seli në Ketzerg 112, 1232, Vjenë, Austri, përmes Shoqatës së Avokatëve Apostolska, Aleksandrovski dhe partnerëve nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 22.02.2023, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Mosburgen GmbH me seli të regjistruar në Ketzerg 112, 1232 Vjenë, Austri, do të fitoj kontrollin mbi shoqërinë Skatolifiçio La Vegia SPA (Scatolificio La Veggia S.p.A.), me seli të regjistruar në Kastellarano (Rexho Emilia), Via Maestrane numër 6, Itali, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 23.12.2022, plotësuar më 07.02.2023 në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga Mosburger GmbH, me seli të regjistruar në Ketzerg 112, 1232 Vjenë, Austri, me të cilën Mosburger GmbH do të fitoj kontrollin mbi Skatolifiçio La Vegia SPA (Scatolificio La Veggia S.p.A.), me seli të regjistruar në Kastellarano (Rexho Emilia), Via Maestrane numër 6, Itali.

Njoftimi i dorëzuar i përqendrimit u parashtrua pas përfundimit të formës së prerë të vendimit të gjykatës së Rexhio Emilija (Reggio Emilia), Itali, e cila miratoi marrjen nga Mosburger GmbH, si blerëse në procedurat e falimentimit të shoqërisë në falimentim Skatolifiçio La Vegia SPA.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Mosburger GmbH është e angazhuar kryesisht në prodhimin e paketimit dhe materialeve të paketimit.

Mosburger GmbH kontrollohet plotësisht nga Prinzhorn Holding GmbH.

XXX¹

Mosburger GmbH nuk është e regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi Prinzhorn gjeneron të ardhura nga shitja e produkteve të paketimit, gjegjësisht materialeve për kuti të valëzuara, si dhe pllaka kartoni të valëzuar dhe kuti kartoni të valëzuar.

Grupi Prinzhorn nuk është e regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Skatolifiçio La Vegia SPA është e angazhuar kryesisht në prodhimin e pllakave të valëzuara, kartonit të valëzuar dhe kutive nga pllakat e valëzuara dhe kartonit të prodhuar në fabrikën e saj.

Skatolifiçio La Vegia SPA nuk është e regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe as nuk realizon ndonjë qarkullim në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

¹ Të dhënat paraqesin fshehtësi afariste

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски